



SEZONI VEROR
20
23



**KALENDARI
ARTISTIK
GUSHT 2023**

“GRUAJA E THYER”

Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”

Data: 06.08.2023

Ora: 19:00

Vendi: Festivali Ndërkombëtar i Teatrit për Monodramë 2023 në Varna City, Bullgari

Data: 13.08.2023

Ora: 20:00

Vendi: Odeoni veror, Pogradec

Data: 16.08.2023

Ora: 20:00

Vendi: Kalaja e Lëkursit, Sarandë

Muriel, 43 vjeç, pas pesë vjetësh që jeton e vetme dhe e mbyllur në apartamentin e saj, mezi pret të nesërmen për t’u takuar me bashkëshortin dhe të birin e mitur, që jeton me të atin. Ajo ka planifikuar të shtrojë gjithë arsyet se përse i biri duhet të jetojë me të ëmën. Mirëpo, gjatë natës, duke kaluar nëpër kalvarin e kujtimeve, ajo

zbërthen, sipas këndvështrimit të saj - të një njeriu perfeksionist - marrëdhëniet e ngushta familjare e shoqërore dhe nuk resht së fajësuarit të tjerët: dy bashkëshortët për dështimin e martesave të saj, të bijën për vetëvrasjen që ka kryer, të ëmën, e cila e ka përbuzur gjithmonë të vëllanë, shoqet e ngushta e deri te fqinjët. Nga ana tjetër, justifikon qëndrimet e saj, duke e paraqitur veten të sinqertë dhe gjithmonë në kërkim të rregullit dhe të një familjeje tradicionale, ku një grua duhet të ketë patjetër një burrë në krah dhe fëmijë për t’u kujdesur, që të fitojë një status të denjë për moralin e shoqërisë.

Në këto kushte, ajo pret ditën e nesërme, e cila nuk i dihet se ç’të ardhme do i sjellë.

Një monodramë e kohës, që trajton boshllëkun njerëzor, vetminë dhe krizën e individit në marrëdhënie me shoqërinë ku jeton.

Një shfaqje bashkëkohore, ku gjithçka buron nga e brendshmjia e personazhit: lëvizja trupore, fjala, imazhi, muzikaliteti, e kënduara dhe e luajtura e muzikës “live”.



“QORRI”

Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”
Produksion i fondit të teatrit për të rinj 2023

Data: 19.08.2023

Ora: 20:00

Vendi: Qendra “Arka”, Shkodër

Regjia dhe teksti: Gerti Palali

Interpretojnë:

Anxhelo Shkreli, Gerti Palali, Lea Lulaj, Endri Lleshi, Ami Dizdari, Mario Prendi,
Ergeza Hoti, Gleni Taipi, Juled Shkjau, Alesia Zefi, Endri Zaganjori

As. regjisor: Marsel Papekaj

Muzika: Eugjen Marku

Koordinator promocioni: Xhuljano Mhilli

Graphic designer: Klaudiana Kimça



19 GUSHT

ORA 20:00

QORRI

Regjia dhe teksti: Gerti Palali

TEK QENDRA RINORE “ARKA”

Interpretojnë: Anxhelo Shkreli, Gerti Palali, Lea Lulaj, Endri Lleshi, Ami Dizdari, Mario Prendi, Ergeza Hoti, Gleni Taipi, Juled Shkjau, Alesia Zefi, Endri Zaganjori

As. Regjisor: Marsel Papekaj Muzika: Eugjen Marku Koordinator Promocioni: Xhuljano Mhilli
Produksion i fondit të teatrit për të rinj 2023

KultArt 2023

SEZONI VEROR 2023



FESTIVALI I MUZAVE: 9 MUZA DHE DURRËSI

Shoqata "Eja në teatër"

Data: 22. 08. 2023

Ora: 20:30

Vendi: Amfiteatri, Durrës

Festivali i muzave ka për qëllim realizimin e tij në qytetin antik të Durrësit për të evidencuar trashëgiminë arkeologjike mijëravjeçare përmes aktiviteteve kulturore. Eventet e planifikuara do të zhvillohen pranë Amfiteatrit, Torrës Veneciane, Murit të Kalasë etj., duke e orientuar festivalin drejt një kulture bashkëkohore me muzikë, rutuale, teatër, film, poezi, fotografi e vallëzime.

"FERMA E KAFSHËVE"

Teatri Kombëtar

Autor: George Orwell

Regjia: Driada Dervishi

Data: 24.08.2023

Ora: 21:00

Vendi: Vlorë

Data: 26.08.2023

Ora: 21:00

Vendi: Durrës

Data: 28.08.2023

Ora: 21:00

Vendi: Shkodër

Një revolucion ndodh në fermën Menër. Kafshët ngrihen kundër njeriut pronar dhe marrin kontrollin e fermës. Por dikush duhet ta zërë vendin e drejtuesit të fermës, e të gjithë bien dakord se duhet ta marrin kafshët më të zgjuara të fermës: Derrat. Napoleoni është derri që bëhet udhëheqësi kryesor i fermës, fillimisht me tone entuziaste vëllazërie e barazie, ai i bind se është e afërt rruga drejt së ardhmes së lirë, ku do të punojnë të gjithë vetëm për vete, larg babëzisë së njeriut. Nuk kalon shumë dhe parimet e premtuara kthehen në vargonj që i lidhin kafshët edhe një herë.



“FOLK TOUR ALBANIA”

Opera on tour
TKOBAP

Data: 08.08.2023

Ora: 20:00

Vendi: Krujë

Data: 10.08.2023

Ora: 20:00

Vendi: Velipojë

Data: 14.08.2023

Ora: 20:00

Vendi: Durrës

Data: 18.08.2023

Ora: 20:00

Vendi: Shëngjin

Koncert me këngë dhe valle tradicionale nga të gjitha trevat shqiptare, promovimi i trashëgimisë sonë kulturore për turistët vendës dhe të huaj.



HIMARA INTERNATIONAL MUSIC FESTIVAL

Edicioni II

Data: 03-10.08.2023

Vendi: Himarë

Lament of the Earth – performancë audio-vizuale nga Donika Rudi

Data: 03.08.2023

Ora: 19.30 & 20.00

Vendi: Kalaja e Himarës (Old Toën)

Kaltrina Miftari, soprano

Agnes Nokshiqi, dance / vallëzim

Doruntina Basha, teksti

Hana Zeqa, kostumi / skenografia

Labinot Rudi, sound / zëri

Data: 3.8.2023

Ora: 21.00

Vendi: Himarë-fshat pranë Kishës së Gjithë Shenjtorëve (Old Town)

ReMusica Vocal Ensemble

RAFET RUDI dirigjent / conductor

“Sonus Albanicus”



Data: 04.08.2023

Ora: 20.30

Vendi: Himarë-fshat pranë Kishës së Gjithë Shenjtorëve (Old Town)

Dorina Selimaj, soprano

String Ensemble

Abigeila Voshtina, violinë

Sara Hoxhallari, violinë

Herida Duro, violë

Mario Guralumi, violonçel

Program: Simoni, Tole & Zadeja

“Muses”

Data: 07.08.2023

Ora: 20.30

Vendi: Himarë-fshat pranë Kishës së Gjithë Shenjtorëve (Old Town)

Rea Veizi & Iliriana Gjoni, piano

Program: Debussy, Dvořák, Fauré, Mozart & Brahms

“Poetic resonances”

Data: 08.08.2023

Ora: 20.30

Vendi: Himarë-fshat pranë Kishës së Gjithë Shenjtorëve (Old Town)

Sebastian Ene, piano

Program: Schubert & Chopin

“The World and I”

Data: 09.08.2023

Ora: 20.30

Vendi: Himarë-fshat pranë Kishës së Gjithë Shenjtorëve (Old Town)

Eliot Quartett & Endri Nini, piano

Program: Mozart & Shostakovich

“Laterna Magica”

Data: 10.08.2023

Ora: 20.30

Vendi: Himarë-fshat pranë Kishës së Gjithë Shenjtorëve (Old Town)

Théo Ould, fizarmonikë / accordion

Program: Campo, Bach, Rameau,

Tchaikovsky & Gubitsch

Himara International Music Festival rikthehet me 7 koncerte, me muzikantë të jashtëzakonshëm të skenave ndërkombëtare. Artistët nga Shqipëria, Gjermania, Franca, Kosova, Rumania, Rusia, Mali i Zi dhe Kanadaja do të rijetësojnë përgjatë 8 ditëve një nga monumentet perla të Bregut. Himara Internation-



al Music Festival starton në datën 3 gusht me performancën audio-vizuale “Lament of the Earth”, e cila është vepër kushtuar efekteve të ndryshimeve klimatike në Tokë dhe ngrohjes globale. Si asnjëherë më parë, kalaja shekullore e Himarës do të ndriçohet nga dritat dhe mesazhi i fortë që performanca përcjell. Kompozitorja Donika Rudi, dramaturgia Doruntina Basha, stilistja Hana Zeqa dhe dy performueset, Kaltrina Miftari dhe Agnes Nokshiqi, janë personalitete të botës shqipfolëse, të cilat gëzojnë një rezonancë ndërkombëtare. Shfaqja do të prezantohet dy herë, në orën 19.30 dhe në orën 20.00, në mënyrë që të gjithë të kenë mundësinë të mos e humbasin.

Hyrja pa pagesë!

web: www.himarafestival.com

FESTIVALI I PORTO PALERMOS

Data: 04, 05, 11, 14.08.2023

Vendi: Kalaja e Porto Palermos

Roberto Ciufoli feat. Jane Landucci & Tess Alice Iacconi

Data: 04.08.2023

Ora: 20:00

Ivan Antonio El Sonero

Data: 05.08.2023

Ora: 20:00

Dren Abazi

Data: 11.08.2023

Ora: 20:00

Olen Cesari

Data: 14.08.2023

Ora: 20:00

Ka nisur në Kalanë e Porto Palermos festivali muzikor i organizuar nga violinisti Olen Çesari, i cili bën bashkë artistë shqiptarë dhe të huaj. Ky festival synon gjithashtu rikthimin e vëmendjes në vlerat e trashëgimisë kulturore.

Festivali, i cili ka nisur që në 16 korrik, do të vazhdojë për çdo fundjavë në hapësirat e kalasë, duke bashkuar jo vetëm artistë shqiptarë, por edhe të huaj. Porto Palermo Festival do të shoqërojë çdo udhëtar që drejtohet për në Jug të Shqipërisë, deri më 14 gusht.

Kanë mbushur netët e këtij festivali që nga Elina Duni tek Eda Zari, Gëzim Myshketa, Josif Gjipali, Kastriot Tusha, Marsela Çibukaj e shumë të tjerë.



SHKODRA JAZZ FESTIVAL 2023

Data: 07-27.08.2023

Vendi: Shkodër
"Rrok Academy"
Andrra vazhdon...

Data: 07-27.08.2023

Dega Jazz - Markelian Kapidani & bash-
këpunëtorët

Data: 14-27.08.2023

Dega Klasike - Paçalin Zef Pavaci & bash-
këpunëtorët

Data: 14-27.08.2023

Dega Fizarmonikë - Bardh Jakova

Data: 07-20.08.2023

Dega Klasike Junior- Brixhilda Martini & bash-
këpunëtorët

Data: 07-20.08.2023



LIRIKA NË DIVANIN LUNXHIOT

Data: 11, 12.08.2023

Ora: 18:30

Vendi: Dhoksat, Lunxhëri, Gjirokastrë

Edicioni i nëntë i këtij eventu kulturor të përzier me traditë, kostume popullore, panair kulinarie, simpoziume shkencore, botim gazete kulturore etj., do të zhvillohet në Lunxhëri dhe synon të ruajë traditën, të shpallorë vlerat kulturore më të mira të kësaj zone dhe të rrisë ndërgjegjësimin e komunitetit për kujdes ndaj këtyre vlerave. Programi i veprimtarisë

DITA E PARË

18:30 Hapja e panairit të kulinarisë.

19:00 Koncerti me këto grupe :

Grupi i lagjes Cfaqë Gjirokastrë

Ansambli i valleve popullore Gumenicë Greqi

Visaret e Krrabës, Tiranë

Këngëtarja e folkut Angjelina Rustemi

Grupi "Djemtë e Kolonjës", Gjirokastrë

Sazet e qytetit të Gjirokastrës

Grupi i Zagories

Dita e dytë

18:30 Hapja e panairit të artizanatit

19:00 Koncerte me këto grupe:

“Zëri i bilbilit”, Vlorë

Grupi i Fushëbardhës

Orkestrina e sazeve të Roshnikut, Berat

Këngëtarja Nikol Cabeli

Grupi “Krojet e Velçës”

Grupi i këngëve dhe valleve nga Dibra e Madhe, Maqedonia e Veriut

Ansambli i këngëve dhe valleve të Dervişanit, Dropull

Ansambli folklorik “Lunxhëria”




EKSPOZITA FOTOGRAFIKE E VËLLEZËRVE JANAKI E MILTON MANAKI

Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”, në bashkëpunim me Arkivin e Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut - Departamenti i Manastirit hapi ekspozitën e vëllezërve Janaki Manaki (1878-1954) e Milton Manaki (1880-1964), kuruar nga Luçjan Bedeni.

I ruajtur në Arkivin Historik të Manastirit, koleksioni i tyre përmban 6702 negativë në xham, 2087 plan film dhe 1071 film rul, 7041 stampime fotografike, 3867 dokumente dhe 49 kamera dhe materiale të tjera, ndërsa në Kinotekën e Maqedonisë së Veriut ruhen një sërë filmash që ata realizuan me ‘Kamera 300’, prej së cilës njihen edhe si themelues të kinematografisë në Maqedoninë e Veriut.

Ekspozita i kushton një vëmendje të veçantë popullatave lëvizëse, përafërsive etnografike dhe ritualeve të ngjashme të popujve të Ballkanit, të cilat i gjejmë të pasqyruara në rrugëtimet e Manakëve në rajon.

Ky aktivitet është një nga stacionet e sezonit veror “KultArt” 2023, organizuar nga Ministria e Kulturës dhe i realizuar në bashkëpunim me Arkivin e Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut - Departamenti i Manastirit.



“TERRITORE TË PËRVOJAVE TË JETUARA”

Ekspozitë

Edi Hila

Artisti i mirënjohur Edi Hila sjell përjetime të viteve të fundit mes pandemisë, luftës e krizës. Zef Paci, kuratori i ekspozitës “Territore të përvojave të jetuara”, shprehet se kjo përzgjedhje e veprave të artistit Edi Hila përbën një meditim mbi ato territore përjetimesh që pohojnë rropatjen e pareshtur të qenies njerëzore me besim përballë fatalitetit.



Data: Deri në 10.08.2023

E hënë - e premte: 9:30 - 14:00 & 17:30 - 20:30

E shtunë: 17:30 - 20:30

Vendi: COD

CIKËL ME LEKSIONE TË HAPURA ME TEMË TRASHËGIMINË KULTURORE DHE HISTORINË

Data: 03.08.2023

Ora: 11:00

Vendi: Salla "Kostandin Shpataraku, Muzeu Historik Kombëtar

“LOGU I BJESHKËVE”

Shoqata “Logu i Bjeshkëve”

Data: 06. 08.2023

Ora: 10:00

Vendi: Malësi e Madhe, Kelmend

Një festë për vlerat më të mira të traditës së “Logut të Bjeshkës”, si dukuri e trashëgimisë kulturore jomateriale. Riti i Logut të Bjeshkëve është një dukuri e transmetuar brez pas brezi, që i bën jehonë jetës, bukurisë së femrës shqiptare, natyrës dhe bukurisë së saj.



FESTIVALI “NONA”

Festa e Gjysheve Shqiptare

Shoqata Albania s'ka Problem

Data: 11, 12, 13.08.2023

Ora: 18:30

Vendi: Sheshi, Përmet



pjesëmarrjen e gjysheve shqiptare dhe një publik i gjerë, me synim gjallërimin e kësaj zone dhe rritjen e numrit të turistëve.

Gjyshe nga gjithë Shqipëria do të mbledhen për të katërtin vit në Përmet, në festivalin e gjysheve tona duararta. Takime brezash në festën më speciale, nën moton “Respekt-dashuri-trashëgimi”. Aktiviteti ka për qëllim promovimin e kulturës dhe traditave tona kombëtare, përcjelljen e tyre brez pas brezi, si dhe rritjen e vëmendjes ndaj brezit të tretë, duke i angazhuar në aktivitetet sociale, etnokulturore dhe evente kulturore që ndërthurin kulturat dhe traditat shqiptare. Festa do të realizohet në Përmet, me

RRUGËTIM NË GJURMËT E TRADITËS

Shoqata "Shën Kozmai"

Data: 18.08.2023

Ora: 19:30

Vendi: Finiq, Sarandë

Festivali Folklorik Ndërkombëtar do të mirëpresë grupe folklorike të Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit, duke promovuar traditat kulturore dhe etnografike te brezi i ri. Projekti përfshin festivalin me parada kostumesh, ekspozita fotografike, guidë për turistët dhe përcjell vlerat e zonës së Finiqit etj.

"NJË ARTIZANE, NJË PEMË"

Shoqata "Arti në Duart e Gruas"

Data: 25, 26.08.2023

Ora: 10:00

Vendi: Pazari i vjetër, Korçë

Ekspozitë me pjesëmarrjen e grave, vajzave të qytetit të Korçës, në kuadër të sezonit turistik. Me qëllim rritjen e numrit të vizitorëve dhe ruajtjen e artizanatit do të realizohet ekspozitë e punimeve artizanale.

"OBJEKTET E PANDELI CALES NË MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR"

Bisedë e hapur

Data: 03.08.2023

Ora: 11:00

Vendi: Salla "Kostandin Shpataraku, Muzeu Historik Kombëtar

Ky aktivitet zhvillohet me rastin e 100-vjetorit të ndarjes nga jeta të Pandeli Cales (1874-1923), veprimtar i Rilindjes Kombëtare dhe i periudhës së Pavarësisë.

HOMAZH VIKTIMAVE DHE TË PËRNDJEKURVE TË KOMUNIZMIT

Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"

Përditësimi dhe publikimi i jetëshkrimit të personave të dënuar gjatë komunizmit dhe ngjarjeve historike.

Përkujtimi i Kasëm Trebeshinës

Data: 08.08.2023

Ora: 11:00

Përkujtimi i Sokrat Dodbibës



Data: 08.08.2023

Ora: 11:00

Përkujtimi i Dom Jak Bushatit

08.08.2023

11:00

Përkujtimi i Havzi Nelës

Data: 10.08.2023

Ora: 11:00

Përkujtimi i Fran Mirakës

Data: 13.08.2023

Ora: 11:00

Përkujtimi i Musine Kokalarit

Data: 14.08.2023

Ora: 11:00

Përkujtimi i Rrok Gerës

Data: 15.08.2023

Ora: 11:00

Përkujtimi i Gjon Shllakut

Data: 16.08.023

Ora: 11:00

Përkujtimi i Imzot Irine Banushit

Data: 18.08.2023

Ora: 11:00

Përkujtimi i Ditës së Viktimave të Nazizmit dhe Komunizmit

Data: 23.08.2023

Ora: 11:00

Përkujtimi i At Zef Pllumit

Data: 28.08.2023

Ora: 11:00

Përkujtimi i Sherif Merdanit

Data: 29.08.2023

Ora: 11:00

Përkujtimi i Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve me Forcë

Data: 30.08.2023

Ora: 11:00

Përkujtimi i Maks Velos

Data: 31.08.2023

Ora: 11:00

AKTIVITET NË KUADËR TË DITËS EUROPIANE NË KUJTIM TË VIKTIMAVE TË STALINIZMIT DHE NAZIZMIT

Data: 23.08.2023

Vendi: Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”

Aktivitet – takim me panel drejtues në kuadër të Ditës Europiane në Kujtim të Viktimave të Stalinizmit dhe Nazizmit.

VARG “FESTIVAL”

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Data: 8-10 gusht 2023

Ora: 19:00 – 21:00

Vendi: Pogradec

“Varg Festival” synon të udhëtojë në qytetet turistike, duke i dhënë jetë metaforës së takimit të vargjeve me valët, në kuadër të fushatës “Libri dhe Turizmi” të ndërmarrë nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit përgjatë verës 2023, që synon të afrojë turizmin me kulturën jo vetëm përmes trashëgimisë kulturore, por edhe përmes aktiviteteve artistike në qytetet bregdetare e bregliqenore.

Programi

Dita I, 8 gusht 2023,

ora 19:00 – 21:00

“Poezia e liqerit”

Në panel:

Natasha Lako

Të afërm të Lasgush Poradecit

Dita II, 9 gusht 2023,

ora 19:00 – 21:00

“Zërat prozaik të liqerit”

Në panel:

Skënder Rusi

Eris Rusi

Dita III, 10 gusht 2023

ora 19:00 – 21:00

“Poetika e poetëve të rinj”

Në panel:

Nurie Emrullai

Enxhi Naumi

Teuta Nunaj



“VARG FESTIVAL”

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Data: 22-24. 08.2023

Ora: 19:00

Vendi: Shkodër

Programi

Dita I, 22 gusht 2023

ora 19:00 – 21:00

“Letërsia për fëmijë”

Në panel:

Xhahid Bushati

Gazmend Krasniqi

Dita II, 23 gusht 2023

ora 19:00 – 21:00

“Komikja dhe tragjikja në letërsinë shqipe”

Në panel:

Ledia Dushi

Stefan Çapaliku

Dita III, 24 gusht 2023

ora 19:00 – 21:00

“Pak letërsi”

Në panel:

Arjola Zadrime

Alban Tufa

“GJIRAFAT S’VALLËZOJNË DOT”

TKEKS

Data: 01.08.2023

Ora: 20:00

Vendi: Pedonalja e Sarandës

Shfaqja më e suksesshme për fëmijë vjen të sjellë atmosferë në qytetin e bukur të Sarandës.

Regjia dhe Koreografia: Semela Skënderasi

Performues: Valentina Myteveli, Mariel Brahimllari, Erta Sina, Semela Skënderasi

Kostume: Sofi Kara

Videoanimacion: Redina Qose

Bazuar në librin për fëmijë me të njëjtin titull, me autor Giles Andreae, është një shfaqje



dansi argëtuese dhe edukative për fëmijë, e cila me anë të gjuhës së trupit tregon se gjithsecili prej nesh është i ndryshëm, por unik në të njëjtën kohë.

“Gjirafat s’vallëzojnë dot” ka në qendër Geraldin, një gjirafë që nuk dinte të kërcente. Geraldin ka katër këmbë të majta, gjunjët i mban gjithmonë përkulur dhe këmbët i ka të ngurta.

Falë ndihmës së Gjinkallës, Geraldin mëson të vallëzojë dhe i habit të gjitha kafshët e xhunglës.

Ai jep një mesazh të fëmijët e vegjël, se nuk ka asgjë të keqe të jesh i ndryshëm dhe t’i bësh gjërat në mënyrën tënde. Secili prej nesh ka një talent që e bën unik, por duhet një shtysë nga familja ose shoqëria për të arritur të gjërat e guximshme.

Ky aktivitet është një nga stacionet e sezonit veror “KultArt” 2023, organizuar nga Ministria e Kulturës, që çon artin e kulturën atje ku është publiku!

“BUZËQESHJA JE TI”

Teatri i kukullave dhe Cirku Kombëtar

Data: 02.08.2023

Ora: 19:00

Vendi: Sheshi qendror, Shirokë

Data: 09.08.2023

Ora: 19:00

Vendi: Këndi i lojërave në pedonale, Shëngjin

Data: 10.08.2023

Ora: 19:00

Vendi: Sheshi qendror në plazh, Spille

Data: 15.08.2023

Ora: 19:00

Vendi: Sheshi i lodrave në Lungomare, Vlorë

Data: 23.08.2023

Ora: 19:00

Vendi: Sheshi para Teatrit “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Performancë artistike argëtuese nga trupa e Teatrit të Kukullave së bashku me trupën e Cirkut Kombëtar.



“SHFAQJE ME NUMRA REPERTORI”

Cirku Kombëtar

Data: 02.08.2023

Ora: 09:00

Vendi: Shirokë

Data: 09.08.2023

Ora: 19:00

Vendi: Shëngjin

Data: 10.08.2023

Ora: 19:00

Vendi: Spille

Data: 15.08.2023

Ora: 19:00

Vendi: Vlorë

Data: 23.08.2023

Ora: 19:00

Vendi: Durrës

Numra artistikë nga të shtata profilet e cirkut, lojëra interaktive me fëmijët nga klouni; numra artistikë me kafshë, ekuilibristë dhe zhonglerë.



“ARKEOLOGU I VOGËL”

Data: 10.08.2023

Ora: 10:00

Vendi: Muzeu Historik Kombëtar

Fëmijët të shoqëruar edhe nga mësuesja e tyre, si fillim do të bëjnë një guidë në muze. Ata do të njihen imtësisht me Pavijonin e Lashtësisë dhe me objektet e zbuluara në vite prej ekspeditave arkeologjike. Më pas nxënësit në atrium do të zhvillojnë pjesën tjetër të aktivitetit, që ka të bëjë me imitimin e gjurmëve dhe gjetjen e objekteve antike. Pas gjurmëve fëmijët do të vizatojnë objektet e gjetura, si dhe plotësojnë disa fjalëkryqe me terma që përdoren në arkeologji.

“NJË DITË NDRYSHE NË MUZE”

Data: 24.08.2023

Ora: 09:00

Vendi: Muzeu Historik Kombëtar

Fëmijët të shoqëruar edhe nga mësuesja e tyre, si fillim do të bëjnë një guidë në muze. Ata do të njihen imtësisht me Pavijonet e Muzeut Historik Kombëtar dhe me objektet e zbuluara në vite prej ekspeditave arkeologjike. Më pas nxënësit do të zhvillojnë aktivitetin me broshurat e lojës “E ka kush e ka- Xhubleta”.